



Raport monitorues V

mbi punën e legjislativit të komunës së Lipjanit
Qershor 2012

Përmbajtja:

- Hyrje,
- Qëllimet e monitorimi të punës së Kuvendi të Komunës së Lipjanit,
- Përmbledhje ekzekutive,
- Dinamika e punës së Kuvendit,
- NOTIMI,
- TRENDI I DISKUTIMEVE,
- ÇËSHTJET E INICIUARA,
- PYETJET E PARLAMENTARE,

Adresa: Rr."Dr. Avdi Avdiu" 14000 Lipjan

Tel.+377 (0) 44 786 414 & +386 (0)49 823 140

e-mail: info.yahr@gmail.com

ueb faqja: <http://www.ngoyahr.weebly.com>

<http://www.yahr-monitorimi.weebly.com>

Hyrje

Organizata Joqeveritare YAHR- do të vazhdojë me monitorimin e aktiviteteve të legjislativit dhe të ekzekutivit të Komunës së Lipjanit ,gjatë periudhës katër vjeçare 2009/2013 dhe do të dal me raporte monitoruese- vlerësuese për çdo gjashtë muaj.

Youth Association for Human Rights /YAHR që nga vitit 2009 është duke bërë monitorimin pro aktiv të punës së kuvendit të Komunës së Lipjanit. Në monitorimin e punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për periudhën gjashtë mujore, nëpërmes këtij raporti YAHR prouon të kontribuoj në ofrimin e informacioneve të strukturuar të cilat do të jenë në shfrytëzim, para së gjithash për qytetarin e Komunës së Lipjanit, shoqërinë civile, mediat, si dhe vetë institucionin e monitoruar, Kuvendin e Komunës së Lipjanit. Në këtë drejtim, në formë të renditur nëpërmes këtij raporti ofrojmë të dhëna të cilat pasqyrojnë disa aspekte të punës së Kuvendit. YAHR nëpërmjet monitorimit pro aktiv dhe por edhe në bashkëpunim me institucionin e Kuvendit si dhe palë të përfshira në këtë proces, YAHR ka arritur t'i siguroj këto informacione, të cilat do të mund të zhvilloheshin edhe më tej, në rast të një bashkëpunimi më cilësor nga ana e institucioneve, apo edhe në rast të organizimit dhe funksionimit të tyre më të mirëfilltë. Nëpërmes aktiviteteve monitoruese YAHR është përfshirë në këto drejtime si puna në seanca plenare dhe puna në Komitetet.

Në hartimin e këtij raporti të pestë monitorues për punën e legjislativit të Kuvendit komunal të Lipjanit, YAHR është mbështetur në shumë burime të informacionit: monitorimin e mbledhjeve të bordit të drejtorëve, monitorimi i seancave të Kuvendeve Komunale, Komiteteve për Politikë dhe Financa, analizimit të dokumenteve të ndryshme si procesverbale dhe rendet e ditës, analizimi i raporteve të medieve të shkruara dhe elektronike, debatet si dhe diskutimet e organizuara nga shoqëria civile.

Bekim Krasniqi

Drejtor ekzekutiv i YAHR-it

Qëllimet e monitorimi të punës së Kuvendi të Komunës së Lipjanit

YAHR në tentativë për të adresuar interesat dhe brengat të qytetarëve në mënyrë të paanshme dhe apartiake u ofron qytetarëve informata në mënyrë të vazhdueshme. Synimi i monitorimit të punës së zyrtarëve të zgjedhur është ndërtimi i një shoqërie të qëndrueshme demokratike.

Qëllimet e monitorimi të punës së zyrtarëve komunal janë:

- Që të sigurohet kredibiliteti i proceseve politike;
- Që të sigurohet përgjegjshmëria e zyrtarëve të zgjedhur ndaj qytetarëve dhe që ata të jenë përfaqësues të vërtetë të interesave të shoqërisë;
- Që të sigurohet transparenca në punën e zyrtarëve të zgjedhur;
- Që të sigurohet pjesëmarrja e qytetarëve në proceset politike vendore;
- Që të parandalohen parregullsitë e mundshme, aktivitetet mashtruese dhe kërcënimet;
- Që të inkurajohen zyrtarët e zgjedhur në punën e tyre për gjetjen e zgjidhjeve që rëndojnë shoqërinë civile;
- Që zyrtarëve të zgjedhur t’iu ofrohen informata mbi brengat e vërteta me të cilat ballafaqohet shoqëria civile;
- Që të informohen qytetarët se si zyrtarët e zgjedhur trajtojnë brengat e tyre si bazë për çfarëdo veprimi qytetar drejt zgjidhjes së atyre brengave.



Përmbledhje ekzekutive

Youth Association for Human Rights (YAHR) publikon raportin e monitorimit “Qeverisja Lokale në Lipjan” bazuar në monitorimin e punës së Kuvendit komunal të Komunës së Lipjan gjatë periudhës Janar – Qershor 2012. Monitorimi është fokusuar në Asambleenë Komunale dhe Ekzekutivin e Komunës, dhe përfshinë fushat: transparenca dhe llogaridhënia, demokratizimi dhe qeverisja e mirë, zhvillimi urban e ekonomik, arsimi dhe shëndetësia.

Raporti gjithashtu përmban analiza kualitative të legjislacionit në fuqi dhe praktikave më të mira mbi vetëqeverisjen lokale të cilat përdoren në lidhje me të gjeturat dhe përgjegjësitë e Komunës. Nga të gjeturat e monitorimit.

YAHR vlerëson se legjislativi i Komunës së Lipjanit ka pasur probleme serioze në fusha të caktuara. Kuvendi komunal është duke vepruar në disa raste në kundërshtim me legjislaturën në fuqi , edhe vetë rregulloret e miratuar nga ana e këtij organi .

Me 25 janar 2012: YAHR-i ka shprehur shqetësimin lidhur me iniciativën e Kuvendit Komunal të komunës së Lipjanit për rritjen e të ardhurave personale si deputet të kuvendit komunal e cila do të ndikonte drejtpërdrejtë

në mirëqenien e qytetareve të Komunës së Lipjanit. Ku është propozuar që me një vendim të veçantë të rriten pagat e tyre në bazë të formulës me të cilën si paga bazë e anëtarit të Kuvendit Komunal të merret 30% -shi i pagës bazë të deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ku do të thotë një deputet të këtë si bazë të rrogës së deputetit 500.00 €, plus për pjesëmarrje të anëtarit të KK-së në seancat e kuvendit I jepen të ardhura shtesë për çdo seancë në lartësi prej 130 euro dhe për pjesëmarrje në ndonjë komitet 70 €. Që në total në muaj i bëjnë që një deputet ti marrë 700.00 €. Kuvendi Komunal në Lipjani i ka 31 deputet që do të thotë do të shpenzojë në muaj 21,700.00 € vetëm për paga, ndërsa në vit 260,400.00 €.

Arsyeshmëria:

Pse ishim kundër kësaj iniciative:

1. Iniciativa për rritjen e pagës së deputetit komunal është në kundërshtim me udhëzimin administrativë nr.16/2008 për pagesën e stafit politikë në komuna dhe udhëzimin administrative 01/2010 mbi kufizimet e kompensimit dhe marrjes së pagës së zyrtareve komunal.

2. Deputetet komunal nuk mund të krahasohen me deputetet e Kuvendit të Republikës së Kosovës mbi volumin e punës së tyre si deputet. Një deputet komunal (në bazë të monitorimit të punës së tyre nga organizata jonë) maksimumi i angazhimit gjatë një muaji është: një ditë pjesëmarrje në një seancë plenare dhe një ditë eventuale pjesëmarrje në ndonjë komitet, ku do të thotë se ai është i angazhuar në maksimum vetëm dy ditë në muaj dhe ti merr 700.00 € është absurde.



3. Kjo iniciativë do të ngarkonte buxhetin komunal të Komunës së Lipjanit dhe do të ulte investimet kapitale në interes të qytetareve.

4. Kuvendet komunale nuk kanë kompetenca për marrje të vendimeve për rritjen e pagave të deputeteve komunal në bazë të udhëzimeve administrative nr.16/2008 dhe nr. 01/2010 5. Deputet komunal nuk e meritojnë një rritje të tillë të pagës për arsye të mos angazhimit të tyre në mbrojtje të interesit të qytetareve. Në bazë të raportit tonë monitorues të muajit tetor 2011, kemi një pasivitet të theksuar të deputeteve në pjesëmarrje në diskutime. Gjatë viteve 2010/2011 nuk kemi asnjë iniciativë që do të përmirësonte jetën e qytetarëve të Komunës së Lipjanit.

30 Prill 2012: YAHR-i reagon ndaj vendimit të Kuvendit Komunal të Komunës së Lipjanit në seancën 26-të të datës 30 prill 2012 lidhur me shndërrimin e aseteve komunale në këtë rast të llap-topeve në pronësi personale të kuvendareve të Komunës së Lipjanit të këtij mandati.

Edhe pse ideja e ekzekutivit të Komunës së Lipjanit ishte e qëlluar me qëllimi të kursimit të shpenzimeve në dërgimin e materialeve tek kuvendaret nga ajo e shtypur në atë elektronike dhe në këtë mënyrë që të ju jepet në shfrytëzim nga një llap top të gjithëve kuvendareve të Kuvendit komunal. Sot me iniciativën e deputetëve të LDK-së dhe me pëlqim të gjithë kuvendareve tjerë, u mur vendimi edhe pse ishte jashtë ligjshme pasi kryesuesi e kishte mbyllur seancën, që këto aste që janë blerë nga tatimpaguesit e Komunës së Lipjanit ti shndërrojnë në prona personale të kuvendareve të këtij mandat që në vitin e ardhshëm i ju skadon.

Andaj Organizata Joqeveritare Youth Association for Human Rights YAHR e konsideron si vendim i jashtë ligjshëm dhe i pa plotfuqishëm dhe do të ankohe në institucionet tjera relevante.

1 Maj 2012: YAHR me një lëtur të hapur i drejtohet Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Lipjanit z. Lulëzim Rrustemi: Vendimit të Kuvendit Komunal të Komunës së Lipjanit në seancën 26-të të datës 30 prill 2012 lidhur me shndërrimin e aseteve komunale në këtë rast të lloptopeve në pronësi private të kuvendareve të Komunës së Lipjanit të këtij mandati është i kundërligjshëm së pari në kundërshtim me rregulloren komunale për funksionimin e punës së Kuvendit sepse seanca është shpallur e mbyllur pastaj është votuar për marrjen e një vendimit të tillë.

Por, ky vendim po ashtu është në kundërshtim me ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik neni 6, neni 7.1, neni 7.5, neni 7.7 dhe neni 7.8. dhe një veprim i tillë është i ndaluar për zyrtarët e lartë në bazë të dispozitës ligjore të këtij ligji në fjalë në neni 9, ku thuhet: Gjatë ushtrimit të funksionit publik zyrtarit të lartë i ndalohen këto veprime: të ndikojë në vendimmarrje të organeve legjislative, gjyqësore apo ekzekutive duke shfrytëzuar pozitën e zyrtarit me qëllim të përfitimit personal apo të personave të afërt apo të besueshëm;



Kërkojë nga ana juaj si kryesues i Kuvendit që të deklaron se ky vendim nuk është i plotfuqishëm se pari për shkak të shkeljes së rregullores komunale për funksionimin e punës së Kuvendit dhe pastaj edhe që është në kundërshtim me ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Në të kundërtën Organizata YAHR me qëllim të mbrojtjes së parasë publike të taksapaguesve të Komunës së Lipjanit do të ju drejtohet institucioneve përkatës që janë në funksion të mbrojtjes së ligjit.

Asnjë përgjigje zyrtare nuk kemi pasur deri me tani nga ana e kryesuesit të Kuvendit komunal të Lipjanit andaj YAHR me 24 Maj 2012 i drejtohet me një lëtur të hapur Agron Maxhunit – Drejtor i Departamentit ligjor në ministrinë e administrimit të pushtetit lokal (MAPL) lidhur me rastin.

Dinamika e punës së Kuvendit

Që nga konstituimi i Kuvendit të Komunës së Lipjanit më 21.02.2011, Kuvendi ka pasur një proces progresiv për sa i përket dinamikës së punës së vet. Këtë vit 2012 deri me tani janë mbajtur 5 seanca plenare, 5 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe financa. Krahësuar me vitin e kaluar është një gjendje e njëjtë.

Gjatë këtij viti 2012 Kuvendi ka miratuar; një ndryshim rregullore, , ka dhënë 5 vendime të ndryshme, po ashtu ka shqyrtuar njëmbëdhjetë raporte.

Tabela e numrit të vendimeve dhe rregulloreve të Kuvendit Komunal në Lipjan 2012				
Mbledhjet e Kuvendit Komunal	Vendimit për dhënien në shfrytëzim të tokës	Vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm	Vendime të tjera	Rregullore dhe ndryshim rregullore të ndryshme komunale
Seanca XXIII	-	-	-	1
Seanca XXIV	-	-	2	-
Seanca XXV	-	-	-	-
Seanca XXVI	3	-	-	-
Seanca XXVII	-	-	-	-
Gjithsej	3	-	2	1

Lista e vendimeve komunale të miratuar gjatë gjashtë mujorit të vitit 2012:

- Vendim për dhënien e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2010 dhe 2011 në vitin 2012 si dhe ridestinimin (transferim e mjeteve financiare) nga buxheti i vitit 2012 në mesë të programeve dhe kategorive ekonomike.
- Vendim për ndërrim të ngastrave kadastrale në mesë Lipjanit dhe pasurisë shoqërore Minjera e Magnezitit “Golesh” – AKP-së.
- Vendim për dhënien në shfrytëzim të tokës – pasuri shoqërore e KK Lipjan, KBI (Këshilli i Bashkësisë Islame) për Xhamin e fshatit Ribar i Vogël.
- Vendim për dhënien në shfrytëzim të tokës – pasuri shoqërore e KK Lipjan, KBI (Këshilli i Bashkësisë Islame) për Xhamin e fshatit Banullë.
- Vendim për dhënien në shfrytëzim të tokës – pasuri shoqërore e KK Lipjan, KBI (Këshilli i Bashkësisë Islame) për Xhamin e fshatit Konjuh.

Lista e raporteve të shqyrtuara nga Kuvendi komunal gjashtë mujorit të vitit 2012:

- *Raportet e Komiteteve: KPF-së, Komiteti për Komunitete, Komiteti Konsultativ për Shërbime Publike, Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Komiteti për Planifikim dhe Urbanizëm, Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe kategoritë e dalura nga lufta e UÇK-së, Komiteti për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ,*
- *Raporti i punës për vitin 2011 i Kryetarit të Komunës së Lipjanit,*
- *Raporti i Buxhetit dhe i shpenzimeve të Komunës së Lipjanit për vitin 2011,*
- *Raporti mbi masat mobilizuese pas gjendjes emergjente dhe të jashtëzakonshme prej datës 25. 01. 2012 deri me 14. 02. 2012.*
- *Raporti i Komisionit për regjistrimin dhe vlerësimin e pasurisë komunale.*

Lista e rregulloreve dhe planeve komunale të miratuar gjatë gjashtë mujorit të vitit 2012:

- *Ndryshim dhe plotësimi i Rregullores për taksat, tarifat dhe gjobat komunale 1Nr.413-755 të datës 03. 12. 2008*

Organizata Joqeveritare YAHR, e kemi përcjellur punën e legjislativit të Kuvendit Komunal të Komunës së Lipjanit në pesë seanca të mbajtura deri më tani. Në bazë të punës sonë monitoruese të drejtpërdrejtë dhe në bazë të vlerësimeve me anë të fletë notimit kemi konstatuar këto fakte:

FAKTE:

- Kuvendi i Lipjanit është duke vazhduar me shkelje të statutit të komunës që nga mbledhja e dytë të mbajtur në fund të muajit shkurt 2010 . Me rastin e miratimit të emërimeve të drejtoreshave të propozuara nga ana kryetarit Z. Shukri Buja. Ku është shkelur neni 47 i statutit të Kuvendit të Komunës së Lipjanit të miratuar me datën 26.09.2008, ku parashihen të jenë 10 drejtorë ,ndërsa janë emëruar 13 drejtorë në 13 drejtori. Por, ka pasur përpjekje nga ana e legjislativit për harmonizimin e statutit me gjendjen faktike në seancën e gjashtë të datës: 08.07.2010. Por kjo përpjekje ka dështuar në mungesë 2/3 e votave të delegatëve të Kuvendit Komunal.

- Kuvendit Komunal i Komunës së Lipjanit në seancën 26-të të datës 30 prill 2012 ka bërë shkelje ligjore lidhur me shndërrimin e aseteve komunale në këtë rast të llap-topeve në pronësi personale të kuvendareve të Komunës së Lipjanit të këtij mandati. Pra, ky vendim është në kundërshtim me ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik neni 6, neni 7.1, neni 7.5, neni 7.7 dhe neni 7.8. dhe një veprim i tillë është i ndaluar për zyrtarët e lartë në bazë të dispozitës ligjore të këtij ligji në fjalë në neni 9, ku thuhet: Gjatë ushtrimit të funksionit publik zyrtarit të lartë i ndalohen këto veprime: të ndikojë në vendimmarrje të organeve legjislative, gjyqësore apo ekzekutive duke shfrytëzuar pozitën e zyrtarit me qëllim të përfitimit personal apo të personave të afërt apo të besueshëm;
- Po ashtu kemi konstatuar mos efikasitet të punëve të Komiteteve të formuara,
- Organizata jonë gjatë monitorimit të aktiviteteve të deputeteve në seancat e Kuvendit komunal ka konstatuar se mungon një efikasitet e pjesës së opozitës për artikullimin e interesave të qytetarëve. Dhe është për tu çuditur edhe pse shoqëria civile ju drejtohet për përkrahje dhe për zgjidhje të problemeve konkrete, prapë se prapë janë të heshtur.
- Është për tu çuditur edhe pse kritikohet shumë ekzekutivi i komunës nga ana kuvendareve të komunës së Lipjanit, nuk kemi kërkesa për interpelancë .
- Po ashtu, kemi shumë pak pyetje parlamentare që ju drejtohet ekzekutivit të komunës së Lipjanit nga ana e kuvendarëve. Dhe që është më interesante përgjigjet i jep vetë Kryesuesi i Kuvendit komunal e jo përfaqësuesit e ekzekutivit të cilët janë kompetentë lidhur me pyetjen që e ka parashtruar deputeti i caktuar.
- Nga periudha e dy raporteve monitoruese 2010/2011 nga ana e jonë për legjislativin e Komunës së Lipjanit kemi një ulje të pjesëmarrjes së kuvendarëve në diskutime. Që është një shenjë jo pozitive.

REKOMANDIME:

- Kuvendi i Komunës së Lipjanit duhet së shpejti të bëjë ndryshime në statutin komunal të nenin 47, për tu përshtatur me realitetin e krijuar.
- Kuvendi i Komunës së Lipjanit duhet të harmonizoj vendimet me ligjet në fuqi.
- Një opozitë me e zëshme për artikullimin e interesave të qytetareve karshi ekzekutivit të Komunës së Lipjanit.
- Delegatet e Kuvendi i Komunës së Lipjanit duhen të jenë më aktivë dhe më efikas , e sidomos nëpër komitete.
- Bëra publike datat e organizimit të mbledhjeve të komiteteve për qytetarët.

Deputetet e Kuvendit Komunal në Lipjan 2009/2013

Lista e komiteteve në kuadër të Kuvendit Komunal në Lipjan

Komiteti për Politikë dhe Financa			Komiteti për Komunitete		
Nr	Deputetët	Subjekti politik	Nr	Deputetët	Subjekti politik /komuniteti
1	Lulzim Rrustemi	PDK	1	Lumturije Bytyqi	AKR
2	Fitim Selimi	PDK	2	Tefik Krasniqi	PDK
3	Heset Sahiti	PDK	3	Ragip Mehmeti	LDK
4	Enver Kozhani	PDK	4	Zoran Spasiq	serb
5	Sefer Tasholli	LDK	5	Ismajl Gradina	romë
6	Naser Sopjani	LDK	6	Liman Ramadani	ashkali
7	Muhamet Shabani	LDK	7	Adil Gashi	turk
8	Blerim Gashi	AKR	8	Silvana Paliq	kroatë
9	Mevlide Shamolli	LDD	9	Zoran Çirkoviç	malazezë
10	Sylejmon Reçica	AAK			
11	Rizah Qeriqi	PSD			
Komiteti për Planifikim dhe Urbanizëm			Komiteti për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural		
Nr	Deputetët	Subjekti politik	Nr	Deputetët	Subjekti politik
1	Ilir Tasholli	PDK	1	Alban Asllani	AKR
2	Bahtir Bahtiri	PDK	2	Sebahate Qiriqi	PDK
3	Fadil Sylejmani	LDK	3	Ismajl Gashi	PDK
4	Imer Selmani	LDD	4	Faik Lekaj	LDK
5	Afrim Bahtiri	AAK	5	Isak Gashi	LDK
Komiteti për Shëndetësi			Komiteti për Arsime		
Nr	Deputetët	Subjekti politik	Nr	Deputetët	Subjekti politik
1	Mevlide Dulahu	LDK	1	Hajrije Salihu	PDK
2	Banush Gashi	PDK	2	Arian Hasani	PDK
3	Ajvaz Karpuzi	PDK	3	Zetëhane Sefedini	LDK
4	Afrim Pacolli	AKR	4	Hanëmshahe Osmani	LDK
5	Naser Bytyqi	PSD	5	Basri Hashani	AKR

NOTIMI

Vlerësimet e paraqitura në këtë fletënotim janë të bazuara në monitorimin e drejtpërdrejtë të seancave plenare, të Kuvendit Komunal të Lipjanit të cilat reflektojnë performancën dhe angazhimet e tyre në përgjithësi. Rezultatet e notimeve janë të shprehura në përqindje (%).

KATEGORITË

YAHK në këtë fletënotim ka pasqyruar dhe analizuar në mënyrë të përgjithshme performancën si dhe angazhimet e deputetëve të Kuvendit të Komunës së Lipjanit dhe subjekteve politike në kategoritë të paraqitura në vijim:

1. Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancës,
2. Ngritja e çështjeve,
3. Inicimi i çështjeve urgjente,
4. Propozim pika rendit të ditës,
5. Pyetje parlamentare,
6. Amandamentimi i legjislacionit,
7. Kërkesa për interpelancë


Pjesëmarrja e delegateve të Kuvendit në diskutime nga seanca 15-19, në bazë të fletënotimit për se cilin deputet:

Nr	Deputetët	Subjekti politik	Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancës	Ngritja e çështjeve	Inicimi i çështjeve urgjente	Propozim ika rendit të ditës	Pyetje parlamentare	Amandamenti i legjislativ	Kërkesa për interpelancë
1	FITIM SELIMI	PDK	4	0	0	0	0	0	0
2	ENVER KOZHANI	PDK	1	0	0	0	0	0	0
3	LULZIM RRUSTEMI	PDK	0	0	0	0	0	0	0
4	BLERIM LIMANI	PDK	0	0	0	0	0	0	0
5	HESET SAHITI	PDK	3	0	0	0	0	0	0
6	BAHTIR BAHTIRI	PDK	1	0	0	0	0	0	0
7	IDRIZ KRASNIQI	PDK	4	0	0	0	0	0	0
8	ILIR TASHOLLI	PDK	1	0	0	0	0	0	0
9	HAJRIE SALIHU	PDK	1	0	0	0	0	0	0
10	AJSHE OLLURI	PDK	0	0	0	0	0	0	0
11	Makfire Ilazi	PDK	0	0	0	0	0	0	0
12	Sebahate Qeriqi	PDK	0	0	0	0	0	0	0
TOTALI SI GRUP PDK-se			15	0	0	0	0	0	0
13	SEFER TASHOLLI	LDK	8	0	0	0	0	0	0
14	NASER SOPJANI	LDK	1	0	0	0	0	0	0
15	MUHAMET SHABANI	LDK	5	1	0	0	0	0	0
16	RAMADAN GRAIQEVCI	LDK	0	0	0	0	0	0	0
17	RAGIP MEHMETI	LDK	3	0	0	1	0	0	0
18	FAIK LEKAJ	LDK	0	0	0	0	0	0	0
19	VLORA LIMANI	LDK	0	0	0	0	0	0	0
20	MEVLIDE DULAHU	LDK	9	0	0	0	1	0	0
21	Burbuqe Fazliu	LDK	0	0	0	0	0	0	0
TOTALI SI GRUP LDK-se			26	1	0	1	1	0	0
22	ALBAN ASLLANI	AKR	3	0	0	0	0	0	0
23	BLERIM GASHI	AKR	7	0	0	0	0	0	0
24	ALBULENA GASHI	AKR	0	0	0	0	0	0	0
25	LUMTURIJE BYTYQI	AKR	1	0	0	0	0	0	0
TOTALI SI GRUP AKR-se			11	0	0	0	0	0	0
26	SYLEJMON REÇICA	AAK	10	0	0	1	0	0	0
27	JALLDYZE GASHI	AAK	0	0	0	0	0	0	0
TOTALI SI GRUP AAK-se			10	0	0	1	0	0	0
28	FETI KRASNIQI	LDD	6	1	0	0	0	0	0
29	MEVLIDE SHAMOLLI	LDD	8	0	0	0	0	0	0
TOTALI SI GRUP LDD-se			14	0	0	0	0	0	0
30	ZYFER ALIU	ORA	1	0	0	0	0	0	0
31	RIZAH QERIQI	PSD	6	0	0	0	0	0	0
TOTALI			83	2	0	2	1	0	0

TRENDI I DISKUTIMEVE

Gjatë periudhës Janar – Maj 2012 pjesëmarrja në diskutime e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Lipjanit në lidhje me pikat e rendit të ditës është karakterizuar me një ulje krahasuar me vitet tjera. Anëtarët e PDK-së në Kuvendin e Komunës së Lipjanit në këtë periudhë kanë shënuar nivelin më të ultë të pjesëmarrjes në diskutime në katër seancat e mbajtura deri më tani nga periudha Janar – Maj 2012 me 18.07 %, por prapë prijnë në diskutime të përgjithshme të pasuar nga anëtarët e LDK-së me 31.33 %, ku tek LDK-ja kemi një ngritje krahasuar me periudhën Janar-Maj 2011.


Është interesante nga aspekti individual të pjesëmarrjes në diskutime në këtë raport dominojnë partitë më të vogël si SYLEJMON REÇICA (AAK-së) . Është interesante se kemi një angazhim të theksuar të disa deputeteve gjatë kësaj periudhe si: MEVLIDE DULAHU nga LDK-ja dhe MEVLIDE SHAMOLLI nga LDD-ja.



MEVLIDE DULAHU ,

Grafika krahasuese : Qershor-Tetor 2011 dhe Janar-Maj 2011

Kemi një ulje të pjesëmarrjes së deputeteve në debate. Ku nga 31 deputet sa i ka Kuvendi komunal i Komunës së Lipjanit duke i krahasuar në të njëjtën periudhë kohore janar –qershor 2010 dhe janar –qershor 2011. Në vitin 2011 kanë qenë aktivë vetëm 25 deputet aktivë ose 83.33%, ndërsa në të njëjtën periudhë të këtij viti 2012 kemi 20 deputet aktivë ose 66.66% , dhjetë deputet më pak krahasuar me njëjtë periudhën .



Deputetet më aktivë kanë qenë udhëheqësit e grupeve të partive politike në Kuvend: **SYLEJMON REÇICA ,MEVLIDE DULAHU ,SEFER TASHOLLI ,MEVLIDE SHAMOLLI ,BLERIM GASHI ,FETI KRASNIQI,RIZAH QERIQI, MUHAMET SHABANI ,FITIM SELIMI ,IDRIZ KRASNIQI ,HESET SAHITI ,RAGIP MEHMETI ,ALBAN ASLLANI ,ENVER KOZHANI ,BAHTIR BAHTIRI ,ILIR TASHOLLI ,HAJRIE SALIHU ,NASER SOPJANI,LUMTURIJE BYTYQI dhe ZYFER ALIU**

Deputete më pasivë të ashtuquajtur “Shikues” janë:, **BLERIM LIMANI ,AJ SHE OLLURI ,Makfire Ilazi ,Sebahate Qeriqi , RAMADAN GRAIQEVCI ,FAIK LEKAJ ,VLORA LIMANI ,Burbuqe Fazliu ,ALBULENA GASHI dhe JALLDYZE GASHI**


REKOMANDIME:

Një angazhim më efikas i deputeteve në mbrojtje dhe në artikullimin e interesave të qytetareve të komunës së Lipjanit.


Deputet aktivë, me numrin e diskutimeve				Deputetet pasivë, me asnjë diskutim			
1	SYLEJMON REÇICA	AAK	10	1	BLERIM LIMANI	PDK	0
2	MEVLIDE DULAHU	LDK	9	2	AJSHE OLLURI	PDK	0
3	SEFER TASHOLLI	LDK	8	3	Makfire Ilazi	PDK	0
4	MEVLIDE SHAMOLLI	LDD	8	4	Sebahate Qeriqi	PDK	0
5	BLERIM GASHI	AKR	7	5	RAMADAN GRAIQEVCI	LDK	0
6	FETI KRASNIQI	LDD	6	6	FAIK LEKAJ	LDK	0
7	RIZAH QERIQI	PSD	6	7	VLORA LIMANI	LDK	0
8	MUHAMET SHABANI	LDK	5	8	Burbuqe Fazliu	LDK	0
9	FITIM SELIMI	PDK	4	9	ALBULENA GASHI	AKR	0
10	IDRIZ KRASNIQI	PDK	4	10	JALLDYZE GASHI	AAK	0
11	HESET SAHITI	PDK	3				
12	RAGIP MEHMETI	LDK	3				
13	ALBAN ASLLANI	AKR	3				
14	ENVER KOZHANI	PDK	1				
15	BAHTIR BAHTIRI	PDK	1				
16	ILIR TASHOLLI	PDK	1				
17	HAJRIE SALIHU	PDK	1				
18	NASER SOPJANI	LDK	1				
19	LUMTURIJE BYTYQI	AKR	1				
20	ZYFER ALIU	ORA	1				

ÇËSHTJET E INICIUARA

Gjatë katër seancave të mbajtura në periudhën Janar – Maj 2012, nga anëtarët e Kuvendit të Komunës në Lipjanit është interesante se vetëm janë ngritur 2 çështje, dhe atë nga një LDK-ja dhe një nga LDD-ja.




Grafika krahasuese : Janar-Maj 2011 dhe Janar – Maj 2012




PYETJET E PARLAMENTARE

Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Lipjanit gjatë katër seancave të mbajtura në periudhën Janar-Qershor 2012 kanë bërë gjithsej 1 pyetje nga të cilat gjithsej 100 % kanë qenë të lidhura me interesin e qytetarëve të Komunës së Lipjanit.



Grafika krahasuese : Janar-Maj 2011 dhe Janar – Maj 2012



MUNGESAT NË SEANCA

Në Kuvendin e Komunës së Lipjanit në pesë seancat e mbajtura në periudhën Janar –Maj 2012 është vërejtur një karakteristik e mungesë së anëtarëve në fillim të seancave të Kuvendit të Komunës së Lipjanit. Por, megjithatë ka pasur forum për fillimin e seancës.

GJUHA JOPARLAMENTARE

Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Lipjanit gjatë katër seancave të mbajtura në periudhën Janar – Maj 2012 treguan nivel të lartë të kulturës parlamentare duke mos përdorur në asnjë rast gjuhë e cila do të ishte fyese për ndonjë anëtar tjetër të këtij institucioni.

"Ky projekt u financua p rmes grantit te Olof Palme International Center. Mendimet, p rfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura k tu jan  te Autorit( ve) dhe jo medoemos pasqyrojn  q ndrimet e Olof Palme International Center

